

REPUBLIKKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE

NR. 353 REP.

NR. 39 KOL.



PULLE TAKSE



KONTRATE SHITBLERJE KUOTASH

Sot me date 10 Mars 2003 (dymije e tre), para meje noterit *M. Pape* u paraqiten palet e meposhtme te cilet kerkojne redaktimin e kesaj Kontrate Shitblerje Kuotash :

SHITESI : ADRIAN DIZDARI , i biri i Bashkimit, i datelindjes 14.05.1959, banues ne Tirane, rruga "Myslym Shyri", pallati 2, shk 4, ap 29, ortak ne shoqerine "M.S.P TRADE CONCEPT" Sh.p.k , i Perfaqesuar nga zoti Shpetim Beqiraj, me profesion Avokat ,me prokuren me Nr. 4425/1656 date 20.07.2002,noteruar ne Durres .

BLERESI : KLAUS PAPE , banues ne Durres, Lagje Nr. 18, rruga "Aleksander Goga"

OBJEKTI : Shitje e kuotave te ortakut Adrian DIZDARI , zotit Klaus PAPE , dhe largimin nga shoqeria

Shoqeria "M S. P TRADE CONCEPT " Sh.p.k eshte e regjistruar ne Gjykatën e Shkalles se Pare Tirane si Person Juridik me Vendim Nr. 7491 date 21.10.1993, si dhe me ndryshime te Vendimeve me Nr. 7491/1, Nr. 7491/2 , date 29.09.1996. Shoqeria eshte me seli ne Durres , Lagje Nr. 18, rruga "Aleksander Goga " . Kapital Themeltar 7 726 344 Leke . Ortaket e saj jane: 1.Shoqeria "SHERGAR TRADING LIMITED " me 90 % te kuotave ne kapitalin themeltar. 2 Adrian DIZDARI me 10 % te kuotave ne kapitalin themeltar .

Ne Mbledhjen e Asamblese te Jashtezakoneshme te dates 7 Mars 2003, eshte marre ne shqyrtim Oferta date 04.12.2002 e bere nga ortaku zoti Adrian Dizdari i cili i ka ofruar ortakut tjetër, shoqerise "SHERGAR TRADING LIMITED" Sh.p.k, shitjen e kuotave te tij prej 10 % , gje per te cilen ortaku nuk ka reaguar . Ne baze te Ligjit Nr. 7638 date 19.11.1992 " Per Shoqerite Tregetare ", neni 45, 47 per transferimin e pjeseve te kapitalit themeltar tek te tretet, si dhe neni 6 te Statutit , eshte vendosur shitja e kuotave prej 10 % qe zoteron Adrian DIZDARI tek zoti Klaus PAPE.

Shitesi zoti Adrian DIZDARI eshte dakord qe ti shese zotit Klaus PAPE 10 % te kuotave qe ai zoteron ne shoqerine "M.S.P. TRADE CONCEPT " Sh.p.k. dhe te largohet si ortak nga kjo shoqeri .

1.7.2017
NOTERISE
17.06.2017

Bleresi zoti Klaus PAPE eshte dakord te blere vleren e 10 % te kuotave nga shitesi Adrian DIZDARI , duke likuiduar te gjithë shumen menjehere dhe duke u bere ortak ne kete shoqeri me 10 % te kuotave ne kapitalin themeltar.

Kontrata hartohet me vullnet te lire e te plote, palet pasi e lexojne me ze te larte , e pranojne dhe e neneshkruajne sipas ligjit.

Kontrata hartohet ne kater kopje me te njejten vlere, nje prej te cilave do te depozitohet prane Gjykates se Shkalles se Pare Tirane, per te bere ndryshimet ne Regjistrin Tregetar.

SHITESI

Adrian DIZDARI

Perf. nga Av. Shpetim Beqiraj

Shpetim Beqiraj
GP

BLERESI

Klaus PAPE

Klaus Pape

NOTER

Minosor Papa
MB